



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



KONTRATË PUBLIKE KORNIZË
626-26-4747-1-2-1/C200

KOMUNA E MAMUSHËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), Te perfaqesuar nga z.Abaz Foniqi në njëren anë;

dhe

KONTI SH.P.K., Ali Hadri 27, Prizren, (në vazhdim "Furnizuesi"), me numer Bisnesi 810029753 te perfaesuar nga z. Gazmend Bojaxhi ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizim me:

Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë numër identifikues: 626-26-4747-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

Lënda e kësaj Kontrate është Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushës sipas kushteve te kontratës dhe specifikave teknike të paraqitura në dosjen e tenderit.

1	Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë
---	---

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

Nr.	PAISJE SPECIALE MJEKSORE LABORATORIKE PER QKMF MAMUSHE	Njësia matëse	Sasia per 24 muaj
	Analizues komplet automatik i biokimisë klinike Plotësisht i automatizuar, Qasje e rastësishme për rutinë, prioritet i mostrës STAT, Ndërfaqja LIS me dy drejtime (HL7) ose e ngjashme *Kapaciteti: përafërsisht. 250 teste fotometrike në orë, deri në 360 teste në orë me modul ise të integruar. *Moduli opsional Ise i integruar për: Na+, K+, Li+, Cl- në serum, plazmë dhe urinë të holluar ose të ngjashme * Min. 35 reagentë në bord. * Metoda e reagentëve mono, të dyfishtë, të trefishtë. *min. 49 pozicione të mostrës. *Tuba primare (Ø12+13mm Ø 75/100mm), kupat e mostres (3ml). përafërsisht. *min. 9 pozicione të kalibrimit me kurbë të kalibrimit linear/jolinear *min. 8 pikë të holluara automatikisht (regresioni linear, linear sipas pjesës, vijë kub, polinom). *min. 3 pozicione kontrolli me komplet Levy-Jennings. *Lexues bar-kodi i integruar për mostrat dhe reagentët.		

1	*Krahu i pajisur me detektor të nivelit të lëngut (kapacitiv), sensor te goditjeve, sistem parangrohës. ose të ngjashme *Pompë mikromatëse me precizion të lartë për të shpërndarë reagentët dhe mostrat (pa shiringë). ose të ngjashme *Vëllimi i reagentit: 180+400 mikrolitra. përafërsisht. *Vëllimi i kampionit: 1+100 mikrolitra. përafërsisht. *Vëllimi tipik i reagimit 200 mikrolitra. përafërsisht. *Gjatesite valore ne bord: min. 8 nga 340nm në 700nm plus një pozicion te lirë. *Burimi i dritës: Llambë halogjene me jetë të gjatë (2000 orë). ose të ngjashme *Lineariteti fotometrik: 0+3.0 OD. *Kuveta e leximit:min. 80 kivetanë bord te rishperlara të prodhuara në Bionex *Larja e kuvetës: stacion larjeje automatike. ose të ngjashme *Konsumimi i ujit: përafërsisht. 2 litra në orë. *Ftohës me reagent: përafërsisht. 14°C nën temperaturën e ambientit. *L.I.S.: Lidhja me dy drejtime. *Sistemi operativ: Windows™ Përafërsisht- testet: Enzimat: ALT AST ALP ACP a-AMY LDH ChE ADA g-GT CK Lip NAC Li Substrate: TG TChol HDL Kolesterol LDL Kolesterol Glu Hb UREA CR UA TP Alb TBIL DBIL Elektrolitet: Na K Cl Ca Mg P Fe UIBC Proteinat specifike: ASO C3 C4 CRP IgA IgM IgG Mikroalbumin RF TF us-CRP FERR A1Gly Testi i të tjerëve: HbA1c i-FOB	Cope	1
	Analizues hematologjik 3 diferencial 20 parametra standardë dhe 9 për përdorim kërkimor • Analizuesi hematologjik duhet të ketë Barcode Reader, USB etj. Dhe të ketë lidhjen që përfshin HL7 industriale • Analizuesi hematologjik duhet të ketë opsionin e Lidhjes LIS përmes një porti LAN. • Analizuesi hematologjik duhet të ketë portën USB në panelin e përparmë dhe të pasmë. • Analizatori hematologjik duhet të ketë një valvul ndërprerëse pa mirëmbajtje që siguron saktësi, rezultate të sakta dhe marrje të saktë të mostrave. • Analizuesi hematologjik duhet të sigurojë një CBC të plotë prej vetëm 20 µl gjaku Calipar, analizuesi hematologjik venoz duhet të ketë grafenin cadher modern në përdorim të lehtë. • Analizuesi hematologjik duhet të ketë një ekran me prekje minimale 10.4 inç • Analizer hematologjik për të patur një softuer intuitiv që thjeshton rrjedhën e punës. • Analizator hematologjik të ketë analiza të automatizuara hematologjike, thjeshtësimin e proceseve të punës, Analizator hematologjik për të patur regjistrim ID të pacientit. Gjatësia e fushës së identitetit ishte jo më pak se 50 karaktere, • Analizuesi hematologjik duhet të ketë një memorie prej mbi 50,000 të dhënash, • Analizuesi hematologjik nuk duhet të marrë më shumë se një minutë për të përfunduar kampionimin CBC • Analizuesi hematologjik duhet të ketë diapazon të zgjeruar për PLT • Analizuesi hematologjik duhet të ketë këto parametra:		

2	RBC, MCV, HCT, RDW-CV, HGB, MCH, MCHC, PLT, MPV, WBC, LYM#, LYM%, MON#, MON%, NEU#, NEU%, EOS#, EOS%, BAS#, BAS % 9 për përdorim kërkimor: RDW-SD, PCT, PDW, P-LCC, P-LCR, AL#, AL%, IG#, IG% Gama e linearitetit PLT: 0–3000 × 10⁹ /L RBC: 0–8,5 × 10¹²/L WBC: 0–300 × 10⁹ /L HGB: 0–250 g/L Kontrolli i cilësisë Kontrolllet me tre nivele (L, N, H) Statistikat e QC: Mean, SD, CV%, Levey-Jennings dhe X-bar Reagentët 3 reagentë të kyçur me RFID dhe një pastrues i përdorur për analiza: Diluent, -L1 Lyse, - Diluent	Cope	1
3	Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinës së glikoziluar (HbA1c) - Karakteristikat miqësore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajnim. - Udhëzime hap pas hapi në ekran. - Menu shumëgjuhëshe. - Kërkohen vetëm 4 µl gjak nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze. - Mbledhësi inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës.	Cope	1
4	Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinës së glikoziluar (HbA1c) - Karakteristikat miqësore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajnim. - Udhëzime hap pas hapi në ekran. - Menu shumëgjuhëshe. - Kërkohen vetëm 4 µl gjak nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze. - Mbledhësi inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës. I shpejtë dhe i saktë - Rezultatet brenda max 4 minutave. - Përdor metodën e afinitetit me boronat, e cila njihet gjerësisht si metodë pa interferenca. - Diapazoni i matjes: 4–15 % A1c DCCT. - Pasaktësia (Imprecision): CV <3 % në 7 % A1c DCCT. - Nuk ndikohet nga variantet e hemoglobinës (Hb), të cilat nuk shkaktojnë shkurtim të jetëgjatësisë së eritrociteve. - Gjurmueshmëri sipas metodës referente të IFCC-së. Menaxhim efikas i të dhënave - Lexues barkodesh për skanimin e të dhënave të kalibrimit, identifikimit të pacientit dhe operatorit.	Cope	1

	• Ruan deri në min. 7.000 rezultate. • Raportim i dyfishtë i përzgjedhshëm nga përdoruesi. Përdoruesit mund të zgjedhin: ○ % DCCT ○ IFCC mmol/mol ○ eAG mg/dl ○ eAG mmol/l • Portë USB. • Mundësi opsionale për printer etiketash.		
Vërejtje: Pajisjet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe ti plotësojnë specifikat teknike të paraqitura në dosje të tenderit në aneksin I. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin garancionin e tyre për një periudhë minimale prej 2 viteve nga data pranimit teknik të pajisjeve. Garancioni për cilësi të pajisjeve duhet të deklarohet se O.E do ta dorëzojë në momentin e tenderimit, kurse validiteti i garancionit 2 vjeçar fillon me pranimin e paisjes.			

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 19.08.2026 dhe përfundon në datën 18.08.2028

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **20-25** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Insatlimi i paisjeve **2 ditë** dhe trajnimi i stafit **3 ditë** .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë QKMF Mamushe

2.3. Pasijet do të kenë Garancion **24 muaj**.

2.4 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara). Në Mamushe

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është **24,180.00 (Njzetekatërmijëqindetëdhjet Euro.**

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrihen ndryshimeve për riorositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 . garancioni I performances ne vlere 2.418.00 Euro me validitet 25 muaj nga data e neneshkrimit te kontrates.

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

- ne vitin 2026 ne vlere 11.131.00 euro

-ne vitin 2027 ne vlere 13.049 .00 euro

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.



6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues
Komuna Mamushe

O.Ekonomik KONTI SHPK – Prizren

Emri:	Abaz Foniqi	Jaser Milaimi
Pozita:	Drejtor Drejtoria e Prokurimit	I Autorizuar
Nënshkrimi:		
Data:	17.08.2026	17.08.2026
Vula:		

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.
- 1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.
- 1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.
- 1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.
- 1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.
- 1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.
- 1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur

arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Siguria e ekzekutimit

8.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

8.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

8.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 9 Sigurimi

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë të siguruara plotësisht me një valutë lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

9.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Neni 9.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 10 Tatimi

10.1 Furnizuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

10.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

10.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të pranimi të mallrave.

10.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Furnizuesi.

Neni 11 Patentat dhe licencat

11.1 Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 12 Periudha e ekzekutimit të detyrave

12.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e lëshimit të Urdhër Blerjes, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Neni 13.

Neni 13 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

13.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhëra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkakuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

13.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

13.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 14 Vonesat e ekzekutimit

14.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.

14.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 14.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

14.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim

Furnizuesin:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porposine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 15

Suspendimi

15.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

15.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

15.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

15.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

15.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

15.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

15.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i bëjë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

15.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16

Cilësia e furnizimeve

16.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

16.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

16.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 17

Inspektimi dhe testimi

17.1 Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimi me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

17.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

17.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

17.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

17.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

17.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'i japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohej se është gabim pas ri-testimit.

17.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 18

Parimet të përgjithshme të pagesave

18.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

18.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

18.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

18.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 18.2, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

18.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

18.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues është duke blerë në emër të Autoriteteve tjera Kontraktuese, dhe nëse një autoritet kontraktues nuk plotëson obligimet e tij sipas kësaj kontrate sidomos obligimet e Nenit 18.2 furnizuesi mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i ndonjë dhe i të gjitha kontratave të përbashkëta kornizë të konkluduara nga AQP.

Neni 19 Dorëzimi

19.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

19.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

19.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

19.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

19.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 20 Operacionet e verifikimit

20.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

20.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhrë, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtrësinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

20.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguheshin ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

20.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 21 Pranimi i përkohshëm

21.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

21.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njërës nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

21.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimi ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

21.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimi të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimi të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimi përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

21.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

21.6 Pas pranimi të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 22 Obligimet për garanci

22.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

22.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

22.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

22.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

22.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 23 Shërbimet pas-shitjes

23.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 24 Pranimi përfundimtar

24.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 22 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

24.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

24.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 25 Shkelja e kontratës

25.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

25.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

25.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

25.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 26 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

26.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- b) Furnizuesi dështon në përmbytjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

26.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbytjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

26.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

26.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punën së realizuar dhe të bëjë rëxhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

26.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

26.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "*forcë madhore*" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektivit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorësi është mjaft praktike, dhe të angazhohet të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

PJESA III E KONTRATES: Kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pelqimin e të dy palëve kontraktuese.
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	Kushtet dhe detyrimet
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	3.1	Siguria e ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës apo 2.418.00Euro për një periudhë prej 25 muajve. Perketesisht nga data 18.08.2026 deri 17.09.2028
Përgjegjësi a dhe Sigurimi i Kontraktuesit	4.1	Përgjegjësi e kontraktuesit është në rast të shkakimit të dëmeve në persona, staf apo objekte për rreth. Operatori Ekonomik është përgjegjës për sigurimin e punëtorëve të tij dhe do të bartë të gjitha pasojat në rast të ndonjë lëndimi gjatë ekzekutimit të furnizimeve, gjatë transportit dhe në QMF.
Cilësia e furnizimeve	5.0	Furnizimet duhet të kenë cilësi të lartë dhe duhet të përmbahen me përpikëri specifikacionit teknik në dosje të tenderit.
Inspektimi dhe testimi	6.1	Menaxheri i Projektit: Inspektimi i materialit duhet të bëhet nga njësia e pranimit me rastin e dorëzimit të materialit nga kontraktuesi. Në rast të vërejtjes do të njoftohet menaxheri i projektit i cili do të caktohet me vendim nga ana e ZKA-së.

Pagesa	7.1	Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të furnizimeve sipas kontratës.
Obligimet garancionit e	8.1	Operatori ekonomik do të ofrojë mallrat të cilat i përshtaten specifikimeve teknike në dosje të tenderit.
Shërbimet pas shitjes	9.1	Periodha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Menaxherit të kontratës. Furnizuesi Ka dhene garancion per paisjet e dorzuar per 24 muaj .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	10.1	Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	11.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë.



REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E MAMUSHË
MAMUSA - MUNICIPALITY OF MAMUSA

Përkirimi i Çmimit					
Thull: Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n					
Nr. i Komunitet: 626-26-4747-1-2-1					
Nr. i brendshëm 626-26-007-1-2-1					
Specifikacioni teknik minimal					
Nr.	Specifikacioni teknik minimal	Njësia matëse	Sasia për 24 muaj	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi Total
1	Analizues komplet automatik i biokimisë klinike Potenciali i automatizuar. Qasje e rastësishme për rutinë, prioriteti i mostrës STAT. Ndërtim i LIS me dy dritare (HL7) ose e ngjashme *Kapaciteti për analizuesit: 250 teste fotoelektrike në orë, deri në 360 teste në orë me modul shtesë të integruar. *Modul opsional i integruar për: Na⁺, K⁺, Li⁺, Cl⁻ në serum, plazmë dhe urinë të holluar ose të ngjashme * Min. 35 reagjentë në bord. * Metoda e reagjentëve meqë, të dyfishtë, të trifashtë. * Min. 49 pozicione të mostrës. * Tuba primare (Ø12x13mm x 75/100mm), kupa e mostrës (3ml), për analizuesit. * Min. 9 pozicione të kalibrimit me kurorë të kalibrimit linear/dolinear * Min. 8 pikë të holluara automatikisht (regresioni linear, linear sipas pjesës, vijë kub, polinom). * Min. 3 pozicione kontrolli me komplet Levy-Jennings. * Leksuri bar-kodi i integruar për mostrat dhe reagjentët. * Krah i pajisur me detektor të nivelit të lëngut (kapaciteti), sensor të goditjeve, sistem parangrohës, ose të ngjashme * Pomojë mikrometrike me precizion të lartë për të shprehur reagjentët dhe mostrat (pa shtirë), ose të ngjashme * Vëllimi i reagjentit: 180-400 mikrolitra, për analizuesit. * Vëllimi i kampionit: 1-100 mikrolitra, për analizuesit. * Vëllimi i pipetës i reagjentit 200 mikrolitra, për analizuesit. * Gjatësia e vlerës në bord: min. 8 nga 340mm në 700mm plus një pozicion të lirë. * Burimi i dritës: Lampë halogjene me jetë të gjatë (2000 orë), ose të ngjashme * Lineari i fotometrit: 0-3.0 OD. * Kuveta e fotometrit: 80 kuveta në bord të rishpërndara të prodhuara në Biorhex * Lartësia e kuvetës: stacion lartësia automatike, ose të ngjashme * Konsumimi i ujit: për analizuesit, 2 litra në orë. * Ftohës me reagent: për analizuesit, 14°C nën temperaturën e ambientit. * L.I.S.: Lidhja me dy frekuenca. * Sistemi operativ: Windows™ Për analizuesit, testet: Enzimë: AST, ALT, ALP, ACP, a-AMY, LDH, CHE, ADA, a-GT, CK, Lip, Lac, U, Substrate: TG, TC, HDL, Kolesterol, LDL, Kolesterol, Glu, Hb, UREA, CR, UA, TP, Alb, TBIL, DBIL. 20 parametra standardë dhe 9 për përdorim kërkimor * Analizuesi hematologjik duhet të ketë Barcode Reader, USB etj. Dhe të ketë lidhjen që përshin HL7 industriale * Analizuesi hematologjik duhet të ketë opsonin e Ldhjes LIS për mënyrë të LAN. * Analizuesi hematologjik duhet të ketë portën USB në panelin e përparmë dhe të pasmë. * Analizuesi hematologjik duhet të ketë një varur ndërpjesë pa minitabellë që siguron saktësi, rezultate të sakta dhe marrje të saktë të mostrave. * Analizuesi hematologjik duhet të sigurojë një CBC të plotë prej vetëm 20 ul gjaku Capilar, analizuesi hematologjik verëz duhet të ketë grafenë cadherin modern në përdorim të lehtë. * Analizuesi hematologjik duhet të ketë një ekran me madhësi minimale 10,4 inç * Analizuesi hematologjik për të patur regjistrim ID të pacientit. * Analizuesi hematologjik duhet të ketë analizator hematologjik të automatizuar hematologjik, tërësishëm e proceseve të punës. * Analizuesi hematologjik për të patur regjistrim ID të pacientit. * Gjatësia e ftohës së identifikimit tëshë jo më pak se 50 karaktere. * Analizuesi hematologjik nuk duhet të marrë më shumë se një minutë për të përfunduar kampionimin CBC * Analizuesi hematologjik duhet të ketë diapazon të zgjeruar për PLT * Analizuesi hematologjik duhet të ketë këto parametra: RBC, MCV, HCT, RDW-CV, HGB, MCH, MCHC, PLT, MPV, WBC, LYMF%, MON%, NEU%, EOS%, BAS%, SAS % 9 për përdorim kërkimor: RDW-SD, PCT, PDW, P-LCC, P-LCR, ALI, ALI%, IG%, Gamma e lirishtetit PLT: 0-3000 x 109/L RBC: 0-8.5 x 1012/L WBC: 0-300 x 109/L HGB: 0-250 g/L Kontrolli i cilësisë Kontrollat me tre nivele (L, N, H) Statistikat e QC: Mean, SD, CV%, Levy-Jennings dhe X-bar Reagjentët 3 reagjentë të xypur me RFID me një pastureshë i përdorur për analizë: Diluent, L1 Lyse, Diluent	Copë	1	16500.00 €	5280.00 €
2					

3	Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinit të glukozuar (HbA1c) - Karakteristikat mëdore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajtim. - Udhëzime hap pas hapi në ekran. - Menu shumëgjatëshe. - Kërkoren vlerën 4 gjatë nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze. - Mbledhjet inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës.	Copë	1	1200.00 €	1.200.00
4	Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinit të glukozuar (HbA1c) - Karakteristikat mëdore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajtim. - Udhëzime hap pas hapi në ekran. - Menu shumëgjatëshe. - Kërkoren vlerën 4 gjatë nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze. - Mbledhjet inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës. - I shpejtë dhe i saktë - Rezultatet brenda max 4 minuta. - Përdor metodën e airseat me boronat, e cila njihet gjerësisht si metodë pa interferencë. - Dispozicioni i matjes: 4-15 % A1c DCCT. - Pasaktësia (impresion): CV <3 % në 7 % A1c DCCT. - Nuk ndikohet nga variantet e hemoglobinit (Hb), të cilat nuk shkaktojnë shkurtime të jetëgjatësive së eritrocitëve. - Gjurmueshmëri sipas metodës referente të IFCC-së. - Menaxhim efikas i të dhënave - Lexues barkodesh për skanimin e të dhënave të kalibrimit, identifikimit të pacientit dhe operatorit. - Ruan deri në min. 7.000 rezultate. - Raportim i dyfishë i përziejshëm nga përdoruesi. Përdoruesit mund të zgjedhin: 0 % DCCT 0 IFCC mmol/mol 0 eAG mg/dl 0 eAG mmol/l - Portë USB. - Mundësi opsionale për punën atëgjatë.	Copë	1	1200.00 €	1.200.00
Totali i përgjithshëm duke i përfshirë të gjitha taksat dhe tatimet:					24.180.00

Vërejtje: Pajisjet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe të plotësojnë specifikat teknike të paraqitura në dosje të tendentit në aneksin 1. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin garancionin e tyre për një periudhë minimale prej 2 vitesh nga data pranimit teknik të pajisjeve. Garancioni për cilësi të pajisjeve duhet të deklarohet se O.E do ta dorëzojë në momentin e tenderimit, kurse validiteti i garancionit 2 vjeçar fillon me pranimin e pajisjes. Në rast se në specifikat e lartcaktuara pa qëllim është përdorur ndonjë markë tregtare atëherë operatorët ekonomik kanë të drejtë të aplikojnë me një artikull të barasvlerëshëm.

EMRI I OPERATORIT EKONOMIK	
ADRESA E PLOTE	Kontit Shp
PERFAQESJAR NGA:	Ri, Ali Hadri nr.27 - Prizren
EMRI & MBIEMRI	Gazmend Bolaxhiq
POZITA	Drejtor
NENSHKRIMI	<i>[Signature]</i>
DATA	09.07.26
VULA	



 RIKLA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIVETI UBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO UŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHES NA MAMUSA – MUNICIPALITY OF MAMUSA		Përshkrimi i Çmimit Trulli: Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë Nr. i Prokurimit: 626-26-4747-1-2-1 Nr. i brendshëm 626-26-007-1-2-1			
Nr. Specifikacioni teknik minimal		Njësia matëse	Sasia për 24 muaj	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi Total
1. Analizues komplet automatik i biomisë klinike Proteksiti i automatizuar, Qasje e rastësishme për rutinë, prioritet i mostrës STAT, Ndërfaqja LIS me dy drejtime (HL7) ose e ngjashme *Kapaciteti: përfaqësit: 250 teste fotoimetrike në orë, deri në 360 teste në orë me modul isa të integruar. *Moduli opsional lse i integruar për: Na+, K+, Li+, Cl- në serum, plazmë dhe urinë të holluar ose të ngjashme * Min. 35 reagjentë në bord * Metoda e reagjentëve mono, të dyfishtë, të trifashtë, *Min. 40 pozicione të mostrës, *Tuba primare (Ø12x13mm / 75/100mm), kupalet e mostrës (3ml), përfaqësit, *min. 9 pozicione të kalibrimit me kurbë të kalibrimit linear/polinear *min. 8 pikat të holluara automatikisht (regresioni linear, linear sipas pjesës, vijë kub, polinom). *min. 3 pozicione kontrolli me komplet Levy-Jennings. *Lexues bar-kodi i integruar për mostrat dhe reagjentët. *Kritiku i pajisur me detektor të nivelit të lëngut (kapaciteti), sensor të goditjeve, sistem pararegjonës, ose të ngjashme *Pompi mikrocenale me presion të lartë për të shtëpandë reagjentët dhe mostrat (pa shiringë), ose të ngjashme *Vëllimi i reagjentit: 180-400 mikrolitra, përfaqësit. *Vëllimi i kampionit: 1-100 mikrolitra, përfaqësit. *Vëllimi i pipetimit i reagjentit 200 mikrolitra, përfaqësit. *Gjatësia valore në bord: min. 8 nga 340mm në 700mm plus një pozicion të lirë, *Burimi i dritës: Lampë halogjene me jetë të gjatë (2000 orë), ose të ngjashme *Lineareiteti fotometrik: 0-3.0 OD. *Kuveta e leximit: 80 kuveta në bord të rëshpërtara të prodhuara në Biorax *Lajfa e kuvetës: stacion lareje automatike, ose të ngjashme *Konsumimi i ujit: përfaqësit, 2 litra në orë. *Ftohësi me reagjent: përfaqësit, 14°C nën temperaturën e ambientit. *L.I.S.: Lidhja me dy drejtime, *Sistemi operativ: Windows™ Përfaqësit, testat: Enzimat: ALT, AST, ALP, ACP, e-AMY, LDH, CHE, ADA, g-GT, CK, Lp, Na ⁺ , Cl ⁻ , Substrate: TG, TC, HDL, Kolesterol, LDL, Kolesterol, Glu, Hb, UREA, CR, UA, TP, Alb, TBL, DBIL 20 parametra standarde dhe 9 për përdorim klinikor * Analizuesi hematologjik duhet të ketë Barcode Reader, USB etj. Dhe të ketë lidhjen që përfshin HL7 industriale *Analizuesi hematologjik duhet të ketë opsionin e Lidhjes LIS përmes një porti LAN. * Analizuesi hematologjik duhet të ketë portën USB në panelin e përparmë dhe të pasmë, *Analizuesi hematologjik duhet të sigurojë një CBC të plotë prej vetëm 20 µl gjaku Capilar, analizuesi hematologjik venoz duhet të ketë gradientin cather modern në përdorim të lehtë, *Analizator hematologjik të ketë analizë të automatizuar hematologjike, thjeshtësimin e proceseve të punës, *Analizuesi hematologjik për të patur regjistrim ID të pacientit: Gjatësia e fushës së identifikimit është jo më pak se 50 karaktere, * Analizuesi hematologjik duhet të ketë një memorie për mbi 50.000 të dritësh, * Analizuesi hematologjik duhet të ketë dispozitë të zgjeruar për PLT * Analizuesi hematologjik duhet të ketë disa parametra: RBC, MCV, HCT, RDW-CV, HGB, MCH, MCHC, PLT, MPV, WBC, LYMF%, MON%, NEUF%, EOS%, BAS%, 9 për përdorim klinikor: RDW-SD, PCT, PDW, P-LCC, ALF, AL%, IG%, Gama e linfearit PLT: 0-3000 x 109/L RBC: 0-8.5 x 1012/L WBC: 0-300 x 109/L HGB: 0-250 g/L Kontrolli i tollesë Kontrollit me tre nivele (L, N, H) Statistikat e QC: Mean, SD, CV%, Levy-Jennings dhe X-bar Reagentët 3 saguesitë të kësaj me RFID dhe një pasturës i përdorur për analizë: Diluent, *L1 Lysa, * Diluent		Copë	1	16500.00 €	16,500.00
2.		Copë	1	5280.00 €	5,280.00

3. Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinitës së glikoziluar (HbA1c)
- Karakteristikat mëdësore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajtim.
 - Udhëzime hap pas hapi në ekran.
 - Menu shumëgjuhëshe.
 - Kohëzotim vetëm 4 µl gjak nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze.
 - Metodësi inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës.
4. Analizator gjysmë i automatizuar desktop për matjen e hemoglobinitës së glikoziluar (HbA1c)
- Karakteristikat mëdësore për përdoruesin minimizojnë kohën e nevojshme për trajtim.
 - Udhëzime hap pas hapi në ekran.
 - Menu shumëgjuhëshe.
 - Kohëzotim vetëm 4 µl gjak nga shpimi i gishtit ose nga mostra venoze.
 - Metodësi inovativ i gjakut mundëson marrje të lehtë dhe të qëndrueshme të mostrës.
 - I shpejtë dhe i saktë
 - Rezultatet brenda max 4 minuta.
 - Përdor metodën e afinitetit me boronat, e cila njihet gjerësisht si metodë pa interferencë.
 - Dispozicioni i matjes: 4-15 % A1c DCCT.
 - Përsaktësia (Imprecision): CV <3 % në 7 % A1c DCCT.
 - Nuk ndikohet nga variantet e hemoglobinitës (Hb), të cilat nuk shkaktojnë shkurtim të jetëgjatësisë së eritrocitëve.
 - Gjurmueshmëri sipas metodës referente të IFCC-së.
 - Menaxhim efikas i të dhënave
 - Lexues barkodesh për skanimin e të dhënave të kalibrimi, identifikimit të pacientit dhe operatorit.
 - Ruani deri në min. 7.000 rezultate.
 - Raportim i dyfishitë i përzgjedhshëm nga përdoruesi. Përdoruesi mund të zgjedhin:
 - o % DCCT
 - o IFCC mmol/mol
 - o eAG mg/dl
 - o eAG mmol/l
 - Portë USB.
 - Mundësi opsionale për printer mikroplastik.

Copë	1	1200.00 €	1,200.00
Copë	1	1200.00 €	1,200.00
Totali i përgjithshëm duke i përftshi të gjitha taksat dhe tatimet:			24,180.00

Vërejtje: Pajisjet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe të plotësojnë specifikat teknike të paraqitura në dosje të tendent në aneksin I. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin garancionin e tyre për një periudhë minimale prej 2 vitesh nga data pranimit teknik të pajisjeve. Garancioni për cilësi të pajisjeve duhet të deklarohet se O.E do ta dorëzojë në momentin e tenderimit, kurse validiteti i garancionit 2 vjeçar fillon me pranimin e pajisjes. Në rast se në specifikat e lartcaktuara pa qellim është përdorur ndonjë markë tregtare atëherë operatorët ekonomik kanë të drejtë të aplikojnë me një artikull të barasvlershëm.

EMRI I OPERATORIT EKONOMIK	
ADRESA E PLOTE	
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	Konti Shp
POZITA	Pr.Ali Hadri nr 27 - Prizren
NENSHKRIMI	Gazmend Bojaxhiu
DATA	Drejtor
VULA	09.07.26





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810029753

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

KONTI SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društvo sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

ALI HADRI NR.27
Prizren


Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

29/05/2017

31/08/2021

Data / Date / Datum




Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: **10120631**

Plani Dinamik

Për tenderin: "Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë"
Nr.i prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

Artikujt e ofertuar ne tender do te liferohen ne afat maksimal prej 30 ditëve kalendarike nga marrja e porosisë nga Autoriteti Kontraktues.
Liferimi do te filloje ne mareveshje me AK per kohen dhe menyren e instalimeve dhe trajnimeve. Koha e duhur e perafert per instalime dhe trajnime e paraqitur ne tabele. Sipas nevojës trajnimet mund te zgjaten sipas kërkesës së AK.

Nr.	QKMF	Fillimi dhe mbarimi i furnizimit	Kohezgjatja e Instalimit	Kohezgjatja e trajnimit
1	QMKF	20-25 ditë	2 ditë	3 ditë

"KONTI" sh.p.k.



Prizren, 09.07.2026

Deklaratë për mirëmbajtje dhe servisim

Deklojmë se, në rast të paraqitjes së ndonjë defekti gjatë periudhës së garancisë, do të ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe eliminimin e tij brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i pranimi të informatës me shkrim për paraqitjen e defektit nga Autoriteti Kontraktues. Ky afat është i realizueshëm pasi kompania jonë disponon servis të autorizuar, staf teknik të kualifikuar dhe kapacitetet e nevojshme logjistike për ofrimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të ofruara në këtë tender. Angazhohemi që çdo ndërhyrje teknike të kryhet në kohë dhe në përputhje me standardet profesionale, me qëllim të sigurimit të funksionimit të pandërprerë të pajisjeve dhe minimizimit të çdo ndërprerjeje në punën e Autoritetit Kontraktues.

" KONTI " sh.p.k.



Prizren, 09.07.2026

AFATI I LIFERIMIT

Afati iliferimit per paisjet e ofertuara ne tenderin:

Titulli:" Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë."

Nr.i prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

Afati i liferimit do te jete 30 dite nga data e porosise.

" KONTI " sh.p.k.



Prizren, 09.07.2026

sh.p.k.
KONTI

digital medical equipment

NRB/NRF. 810029753 Adresa: Rr.Ali Hadri nr. 27 Prizren
Tel./ Fax.029 241 655, 044 380 780, 044 116 437
Web.www.kontimedical.com,e-mail:konti44@hotmail.com

ProCredit Bank – Prizren
Llogaria Nr. 1125-003727-0001-65
e-mail:sales@kontimedical.com

DEKLARATË PËR SPECIFIKACIONIN TEKNIK PËR PAISJE

Deklarojme qe i plotesojme specifikimet teknike 100% sipas Aneksit 1 të Dosjes se tenderit.

Titulli:“ Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë.”

Nr.i prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

” KONTI ” sh.p.k.



Prizren, 09.07.2026

Garancioni

Garancioni per paisjet e ofertuara ne tenderin:

Titulli: " Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë"

Nr.i prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

do te jete 24 muaj nga data e pranimi te paisjeve.

" KONTI " sh.p.k.



Prizren, 09.07.2026

Garanci Ekzekutimi

Serial 070030060018079

Për **KOMUNA E MAMUSHËS**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË**KONTI sh.p.k.**

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë

të dhënë me numrin e Prokurimt.

626-26-4747-1-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;**DHE DUKE PASUR PARASYSH QË** jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:**PËR KËTO ARSYE** vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej**€ 2,418.00****Dy mije dhe Katër qindë dhe Tetembedhjete €**

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 2,418.00

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen

(shuma e garancisë)

arësyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

17.08.2026

deri më

16.09.2028

Lëshuar në

Dega Prizren

datë

17.08.2026

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGAL Insurance Group

Agjenti: Pranvera Shehu

NRB/NRF. 810029753 Adresa: Rr.Ali Hadri nr. 27 Prizren
Tel./ Fax.029 241 655, 044 380 780, 044 116 437
Web.www.kontimedical.com,e-mail:konti44@hotmail.com

ProCredit Bank – Prizren
Llogaria Nr. 1125-003727-0001-65
e-mail:sales@kontimedical.com

A U T O R I Z I M

Autorizohet bashkëpronari i firmës Jaser Milaimi qe ne emer te Konti shpk te bejë nënshkrimin e kontratës dhe të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me tenderin:

Titulli: “Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë “

Nr. i Prokurimit: 626-26-4747-1-2-1

KONTI sh.p.k.,

G. Bojaxhiu
Gazmend Bojaxhiu



Prizren, 17.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



02 Nr. 216 / 26

Më: 17.08.2026

Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 87.2 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullorës me nr. 002/2024 dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, Kryetari i Komunës Mamushës mori këtë:

VENDIM

Për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

I

Menaxher i kontratës për projektin me titull: “Furnizimi me pajisje specifike mjekësore Laboratorike për QKMF-n në Komunën e Mamushë” me numër të prokurimit: 626-26-4747-1-2-1 dhe me nr. te brendshëm: 626-26-007-1-2-1, emërohet z. Mirat Morina, ndërsa Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës për projektin në fjalë emërohet z. Emre ŠALA.

II

Pas pranimit të kontratës, menaxheri i kontratës do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës duke përdorur funksionin “Fillimi/mobilizimi i kontratës”. Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga sistemi i prokurimit elektronik dhe duhet të përgatitet për të gjitha kontratat me vlere të madhe, të mesme dhe të vogël. Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të ekipi të menaxhimit të kontratës dhe Operatorit Ekonomik, ekipi i menaxhimit të kontratës, do ta ngarkoj një kopje të planit për menaxhimin e kontratës në sistemin elektronik të prokurimit.

III

Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës

Menaxheri i Projektit/Kontratës do të:

a. Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;

- b. Sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
- c. Bëj vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontrates janë:

- a. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- b. Të sigurojë që Operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- c. të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- d. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- e. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- f. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- g. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- i. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- j. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe
- k. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.
- l. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

V

Përgjegjësitë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:

Mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar në platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

VI

Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, duhet t'i përmbahen me përpikëri i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës.

VII

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe vlen deri në ekzekutim të kontratës apo marrjen e një vendimi tjetër me shkrim.

Me këtë vendim të njoftohet:

- *Drejtoria e Shëndetësis dhe mirëqenies sociale,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Pala,*
- *Arkivit.*

Abdülhadi Krasniç
Kryetari i Komunës së Mamushës

